

HYRJJE

Kjo Strategji Partneriteti për Vendin e Grupit të Bankës Botërore mbulon periudhën VF11-VF14 dhe është e para SPV që do të prezantohet që prej aprovimit të Shqipërisë nga IDA në mesin e vitit 2008. Strategjia e fundit e Partneritetit për Vendin për Shqipërinë u aprovua më 10 Janar, 2006 dhe mbulonte periudhën VF06-09. Implementimi i strategjisë u vlerësua përmes një Progres Raporti CAS(Strategjia e Asistencës për Vendin) (CASPR) që ju prezantua Bordit në Maj 2008, dhe përmes një Raporti Përfundimtar CAS (CASCR) bashkangjitur në Shtojcën 2. Mësimet e përcaktuara në CASCR, prioritetet e vendit siç paraqiten në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të Qeverisë, puna analitike e ndërmarrë nga Banka dhe aktivitetet e partnerëve të tjerë të jashtëm luajtën një rol kyç në planifikimin e kësaj strategjie për VF11-14.

Shqipëria hyn në periudhën e re të SPV pasi i ka bërë ballë relativisht mirë krizës financiare dhe ekonomike globale –duke ruajtur një rritje pozitive ekonomike-edhe pse të reduktuar ndjeshëm-për vitin 2009 dhe me një sektor bankar të shëndosh. Ndikimi është ndjerë kryesisht në remitanca dhe në tregti, ndërkohë që ekspansioni fiskal që ndihmoi në zbutjen e ndikimeve të krizës duhet të tërhiqet shpejtë. Duke pasur parasysh perspektivën e pasigurt në Evropë dhe vështirësitë në Greqi-një partner madhor në tregti, investime dhe remitanca – vitet e ardhshme priten të jenë më pak të favorshme. Sfidat kryesore për përmirësimin e perspektivave të rritjes ekonomike për Shqipërinë përfshijnë: (i) vazhdimin sa më të shpejtë të kuadrit të mesëm e të shëndetshëm fiskal dhe forcimin e mëtejshëm të menaxhimit të fondeve publike; (ii) përmirësimin e implementimit të programit tashmë të gjerë të Shqipërisë për reformat rregullatore për të forcuar konkurrueshmërinë dhe nivelet e investimit; (iii) vazhdimësi në zvogëlimin e mangësive infrastrukture përmes një metodave të qëndrueshme fiskale; (iv) zgjerimin e aksesit të sektorit privat ndaj kredisë. Ndërkohë, rritja e ngadaltë ka gjasa të ndihet më shumë tek ata më vulnerabël çka krijon nevojën për një vëmendje më të madhe tek përmirësimi i efektivitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe progres më të shpejtë për indikatorët social. Së fundmi, Shqipëria po njuh sfidën e ndryshimeve klimatike– si vendi i dytë më vulnerabël në Evropë dhe Azi Qendrore – çka lidhet në mënyrë parësore me menaxhimin e burimeve ujore që vendi përdor për energji dhe agrikulturë.

Programi i përbashkët i Grupit të Bankës i paraqitur në këtë SPV fokusohet në implementimin e një programi të gjerë dhe të vazhdueshëm në Shqipëri i cili po mbështet sfidat e sipërpërmendura, ndërkohë që në mënyrë selektive prezanton huan e re të BNRZH prej rreth 275 milion \$, dhe financimin e shtuar të IFC për sektorin privat në një nivel rreth 120-150 milion \$. Nga totali i huasë së BNRZH, e cila është e kushtëzuar nga kapaciteti financiar i BNRZH, vetëm rreth 35 përqind (apo 100 milion \$) mund të mundësohen në formën e mbështetjeve buxhetore të disbursuara shpejt dhe të bazuara në politikat – duke marrë parasysh një kuadër të kënaqshëm makroekonomik – dhe pjesa e mbetur e dedikuar për veprimtari investuese në sektorët social, infrastrukturën bazë, menaxhimin e resurseve natyrorë dhe reformën në sektorin publik. Aktivitetet e reja përshkruhen plotësisht për dy vitet e para të SPV ndërkohë që për dy vitet e tjera janë përfshirë vetëm përshkrime indikative, në mënyrë që të ruhet fleksibiliteti për ta adaptuar programin me rrethana të papritura. IFC do të vazhdojë që gjithashtu të mobilizojë fonde të tjera veçanërisht për pjesëmarrje private në infrastrukturë përmes shërbimeve të saj këshillimore. Kjo strategji e përbashkët do të vazhdojë traditën e bashkëpunimit të fortë midis IFC dhe BNRZH, veçanërisht në sektorët e ujit, transportit dhe

energjisë. Gjithashtu ky raport do të shtjellohet në një fokus më të thellë nën-rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Juglindore në sektorë kyç si elektriciteti, tregtia dhe transporti si dhe lehtësimi dhe menaxhimi i katastrofave.